



REPublika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT
Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Rruga Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palata Pravde, Objekat A, Ulica Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palace of Justice, Building A, Nekibe Kelmendi Street, 10510 HajvaliVËRTETIMI MBI DORËZIMIN E
DOKUMENTITPOTVRDA O DOSTAVI
DOKUMENTAACKNOWLEDGEMENT OF
RECEIPT OF A DOCUMENT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për
Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar
më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o
Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova
za pitanja koja se odnose na Kosovsku
agenciju za privatizaciju, dole potpisana
stranka potvrđuje dostavu dokumenta
navedenog dole:

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special
Chamber of the Supreme Court of Kosovo
on Privatization Agency of Kosovo Related
Matters, the below signed party
acknowledges receipt of the document
described below:

Ndërmarrja: Preduzeće: Enterprise:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

1. Koperativa Bujqësore " Mamusha"

C-IV.-24-0155

18/10/2024

• Mamushë

Padiës
Tužilac
ClaimantI paditur
Tuženi
Respondent

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo			
AGJENCIA KOSOVAJE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU			
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO			
II			
Përfaqësues Punomoćnik Representative	Mr. Br. No.	4432	
Përfaqësues Punomoćnik Representative	Mr. / Fq. Br. Str. No. Pg.	4	Data : Datum 21. 10. 2024 Date :
Prishtinë / Pristina			

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Data Datum Dated
1	Aktvendim nga Gjykatësi	Rešenje sudije	Decision of the Judge	18/10/2024

Pala: Stranka: Party: 1. Agjencia Kosovare e Privatizimit
Authority • Privatization • Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Pranuar nga: Primio: Received by: _____
Titulli: Zvanje: Title: _____
Data: Datum: Date: 21. 10. 2024
Nënshkrimi Potpis: Signature: _____

për shkrimorën - za pisarnicu - for registry



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:243440
Datë: 18.10.2024
Numri i dokumentit: 06320761

C – IV – 24 – 0155

1

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL), për Ndërmarrjen Shoqërore PRZ093, Kooperativa Bujqësore (KB). "Mamusha" me seli në Mamushë (në likuidim) .

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Prishtinë -.,

Për: Parashtruesen e kërkesës

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK)për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës dëgjimore, me dt.18.10.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Raporti Përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit (AL) për Ndërmarrjen Shoqërore PRZ093, Kooperativa Bujqësore (KB). "Mamusha" me seli në Mamushë (në likuidim) dhe i kërkesës për mblljen e rastit të likuidimit.

II. LEJOHET mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrjeje Shoqërore, Kooperative Bujqësore.

III. LIROHET Autoriteti i Likuidimit (AL) nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.

2024:243441



Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.05.09.202, parashtuesja e kërkesës, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka dorëzuar Raporti Përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit (AL) për Ndërmarrjen Shoqërore PRZ093, Kooperativa Bujqësore (KB). "Mamusha" me seli në Mamushë (në likuidim) dhe i kërkesës për mbylljen e rastit të likuidimit e në të cilën ka sqaruar se AL-ja i Ndërmarrjes Shoqërore (Ndërmarrja), Kooperativa Bujqësore (KB). "Mamusha" me seli në Mamushë, është themeluar me dt.23 dhjetor 2019, me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), pas kalimi të të gjitha fazave të procesit të likuidimit që nga themelimi i tij ka përcaktuar se PRZ093, KB, "Mamusha" – Komuna e Mamushës, nuk ka evidentuar dhe nuk posedon në emër të saj me asnjë pronë apo aset dhe si i tillë nuk ka gjeneruar asnjë të hyrë nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit dhe rrjedhimisht nuk disponon me find të likuidimit përmes të cilit do të përmbushte detyrimet ndaj kreditorëve, se gjatë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave kreditorë është parashtruar një kërkesë kreditorë kundër Kooperativës Bujqësore (KB). "Mamusha" – Komuna e Mamushës, prandaj konform nenit 43 dhe 44 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit i KB, "Mamusha" në Mamushë, kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, që pas shqyrtimit të kërkesës, të aprovoj Raportin Përfundimtar të KB, "Mamusha" në Mamushë dhe të merr vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit të kësaj ndërmarrje si dhe në pajtim me nenin 46 të Shtojcës së këtij Ligji, edhe formalisht t'a lironi Autoritetin e Likuidimit nga çfarëdo detyrë të mëtejme lidhur me këtë ndërmarrje dhe procedurat e likuidimit lidhur me të.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtuesit të kërkesës, ka konstatuar se kërkesa e Autoritetit të Likuidimit për KB, "Mamusha" në Mamushë për aprovimin e Raportit Përfundimtar të KB, "Mamusha" në Mamushë dhe për lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit të kësaj ndërmarrje, është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L – 034 të AKP-së, parashihet se: *"Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron Raportin përfundimtar, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës "* deri sa paragrafi 2 i këtij neni përcakton se : *"Raporti përfundimtar përmban: një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera, një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme, një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit"* kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton se: *"Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës të kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit"*.

Në nenin 44 paragrafi 1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së,, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.



Me dt.23 dhjetor 2019, me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), është vendosur që fillimi i procedurave të likuidimit duke e përfshirë emërimin e anëtarëve të Autoriteti të Likuidimit të Kooperativës Bujqësore (KB). "Mamusha" me seli në Mamushë, të hyj në fuqi me dt.26 shkurt 2020, sipas autoritetit të dhënë me vendimjn e lartëcekur të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Vendimi mbi emërimin e Autoritetit të Likuidimit është paraqitur në Shtojcën 4 të Raportit Përfundimtar.

Në muajin Mars 2020, Autoriteti i Likuidimit, ka lëshuar njoftimet për fillimin e procesit të likuidimit të kësaj NSh-je, në gazetatat : Zëri, Koha Ditore dhe Kosova Sot dhe Pobjeda, me tirazh të konsiderueshëm në RTepublikën e Kosovës, Serbi dhe në Mal të Zi, se kopjet e njoftimeve janë të paraqitura në Shtojcën 5 të Raportit Përfundimtar. Në anën tjetër, me dt.15 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë Vendimin, nr.01/11 me të cilin është shpallur, "Gjendja Emergjente për Shëndetin Publik" për shkak të Pandemisë globale (SARS) – CoV – 2). Duke pasur parasysh rrethanat e krijuara në lidhje me rrezikimin e shëndetit publik, nuk ka pasur njoftim të dytë në gazeta të shtypura në Republikën e Kosovës sipas procedurave, për shkak të pandemisë COVID – 19, gazetatat kishin pushuar së botuari në kopje fizike prej letrës si deri më tani mirëpo janë bërë publikime në portalet Telegraf, Epoka e Re dhe Infokus (shih Shtojca nr.5), Vendimi i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, BD Nr.133/4). Poashtu Bordi i Drejtorëve të AKP-së, me dt.30 prill 2020, ka vendosur që të caktohet një afat i ri shtesë prej 45 (dyzetë e pesë) ditësh për parashtrimin e dëshmimeve të kërkesës dhe të interesit lidhur me Kooperativën Bujqësore, "Mamusha"- Mamushë, si dhe të gjitha njoftimet për kreditorët e AKP-së, të bëhen vetëm në web faqen e AKP-së dhe se kopjet e njoftimeve janë paraqitur në Shtojcën, nr.5 të Raportit Përfundimtar.

Me dt.11.03.2020, Autoriteti i Likuidimit (AL), në pajtim me nenin 19.6 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, ka dërguar njoftimet formale institucioneve relevante për fillimin e procedurës së likuidimit përderisa në fletë kthesat dhe kopjet e librit të pranimin nga PTK-ja, si dëshmi që janë informuar institucionet janë të përmbledhura në Shtojcën nr.6 të këtij Raporti Përfundimtar, siç janë; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, Zyra për Regjistrimin e Pengut e kësaj Agjencie, Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor - Agjencia Kadastrale e Kosovës, Kuvendi Komunal (KK), Mamushë, - Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Mamushë. Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Mamushë, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje ekonomike, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme e Kosovës si dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Në të njëjtën kohë ishte njoftuar Kuvendi Komunal Mamushë - Zyra e Tatimit në Pronë si dhe disa kreditorë tjerë, siç janë KRM, "Ekoregjioni" me seli në Prizren, KRU, "Hidroregjioni Jugor" me seli në Prizren, dhe në Mamushë, KRU, "Gjakova" me seli në Gjakovë, KRM, "Çabrati" me seli në Gjakovë, PTK, ShA, Prishtinë.

Me dt.11 mars 2020, AL-ja për fillimin e likuidimit ndaj kësaj Kooperative Bujqësore, AL-ja kishte enjoftuar edhe Degët e bankave në Kosovë, siç janë : ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, TEB Bank, Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), dhe BpB Bank.

Autoriteti i Likuidimit (AL), bazuar në dokumentacionin nga institucionet relevante ka konstatuar se nuk ka pasur asset të kësaj ndërmarrje për t'u shitur e për këtë qëllim AL-ja, posedon konfirmimin nga Kuvendi Komunë në Mamushë – Drejtoria për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm dhe Kadastër si dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës të prezantuar në Shtojcën 9 të këtij Raporti Përfundimtar.



Autoriteti i Likuidimit (AL) i NSh-së në fjalë, nuk ka identifikuar se kjo ndërmarrje ka në pronësi asete të palujtshme apo të lujtshme të cilat do të mund të realizonin të hyra nga procesi i likuidimit. Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Komuna e Mitrovicës –Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër kanë konfirmuar se NSH-ja nuk ka regjistruar kurrfarë prone të patundshme në emër të NSh-së.

Në Raportin Përfundimtarë, është cekur se gjatë afatit ligjor për parashtrimin e kërkesave kreditore, është parashtruar 1 (një) kërkesë kreditore kundër Kooperativës Bujqësore (KB). "Mamusha" – Komuna e Mamushës, e cila është e përshkruar në Shtojcën 7 të tij, AL-ja, ka konstatuar se KB, "Mamusha" – Komuna e Mamushës, nuk kaasete dhe si e tillë nuk ka të gjeneruara të hyra, e parashtruesit të kërkesës, i është dërguar njoftimi për mungesë së fondeve të likuidimit për përmbushjen e detyrimeve e njoftimi i tillë, është i bashkangjitur në Shtojcën 8-të të Raportit Përfundimtar.

Po ashtu këtij Raporti, gjegjësisht në Shtojcën 10 të tij, i është bashkangjitur edhe shkresa nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e me të cilën konfirmohet se nuk është parashtruar asnjë ankesë kundër ndërmarrjes në fjalë dhe rrjedhimisht nuk ka pasur Vendime të marrura nga Autoriteti i Likuidimit, se të hyrat nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit, janë zero (€ 0) për faktin se ndërmarrja nuk ka asete të evidentuara në emrin e saj, ndërsa shpenzimet e likuidimit kanë arritur në vlerë prej € 850.00 (të mbuluara nga Buxheti i Republikës së Kosovës) që e njoftimeve për fillimin e likuidimit dhe shpenzimet e tjera operative, e Pasqyra Përfundimtare e llogarisë bankare në likuidim, është paraqitur në Shtojcën 11 të këtij Raporti.

Sipas Raportit Përfundimtar, në Pasqyrën Përfundimtare Financiare, ka deklaruar se të ardhurat nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit janë zero (0) €, për faktin se ndërmarrja në fjalë nuk ka pas ndonjë pasuri në posedim ose pronësi, ndërsa shpenzimet e likuidimit kanë arritur vlerën prej 1,104.80 € të mbuluara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, që përfshijnë shpenzimet e njoftimeve dhe shpenzime të tjera operative .

Autoriteti i Likuidimit (AL), ka konstatuar se ka marrë konfirmimet nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), se KB, "Mamusha" në Mamushë, nuk ka obligime ndaj ATK-së kurse nga Komuna e Mamushës kanë marrë konfirmimin se kjo NSh, nuk ka obligime të tatimet në pronë e këto konfirmime për këto çështje janë të bashkangjitura në Shtojcën 12 dhe 13 të Raportit Përfundimtar derisa në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me dt.29 Gusht 2024, Bordi i Drejtorëve është informuar nga AL-ja, lidhur me përmbajtjen e Raportit Përfundimtar të Kooperrativës Bujqësore, "Mamusha" – Mamushë. Meqenëse nuk ka mjete financiare në dispozicion pasi NSh-ja, nuk kishte asete për shitje, gjykata në pajtim me nenin 47 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së vendosi se kërkesat e tilla kreditore shuhën me ligj dhe çdo veprim për të inkasuar borgjet e tilla ndalohet kurse Autoriteti i Likuidimit (AL) mbetet përgjegjës për veprimet apo lëshimet jo ligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46 paragrafi 2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Duke qenë se, gjykata konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit përkatësisht Autoriteti i Likuidimit (AL), i ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe vendimet e nevojshme për mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSh-je, në pajtim me ligjin e me arsyet e cekura më lartë,



DhPGjSK-ja, e aprovoj Raportin Përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit (AL) për Ndërmarrjen Shoqërore PRZ093, Kooperativën Bujqësore (KB). "Mamusha" me seli në Mamushë (në likuidim), kërkesën për mblljen e rastit të likuidimit, e lejoj mbylljen e rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrjeje Shoqërore, Kooperative Bujqësore, si dhe vendosi që të lirohet Autoriteti i Likuidimit (AL) nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4, dhe 9 të Ligjit, Nr.06/L – 186 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) lidhur me nenin 43 dhe 44.2 të Shojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR
ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

2024:243440, 18.10.2024

Gjykatësi,
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së nga pranimi të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

